

UDHËZIME PËR PRINDËRIT E FËMIJËVE PAS NJË OPERACIONI TË NGUSHTIMIT TË LAFSHËS NË ZONËN GJENITALE

Të nderuar prindër!

Fëmija juaj ka kryer një operacion të ngushtimit të lafshës në zonën gjenitale. Po e nxjerrim nga spitali për ta kaluar atë në kujdesin shtëpiak. Data e kontrollit është e shënuar në vërtetimin e nxjerrjes nga spitali.

Pas procedurës, fëmija duhet të pushojë disa ditë. Nëse ai ankohet për dhimbje, jepini barna kundër dhimbjeve. Ju mund t'i blini ato pa recetë në një farmaci ose mjeku personal i fëmijës suaj mund t'jua japë me recetë.

Ju rekomandojmë që të vendosni kompresë në zonën gjenitale të fëmijës, të cilat duhet të ndërrohen sa herë që urinon, ose 4 deri në 6 herë në ditë, për sa kohë që zona gjenitale është e fryrë. **Ndërrojeni edhe gjatë natës! Për kompresat përdorni vetëm garza sterile dhe tretësirë fiziologjike, të cilat mund t'i merrni në farmaci.**

Pasi ënjtja të ketë rënë, tërhiqeni me kujdes lafshën poshtë mbi kokën e penisit dhe sërish mbrapa. Përsëriteni këtë çdo ditë gjatë larjes.

Lani duart tërësisht para dhe pas ndërrimit të kompresave!

Nëse zona gjenitale e fëmijës suaj fryhet shumë, nëse vëreni një rrjedhje me erë të keqe, ose nëse fëmija juaj ka dhimbje të forta dhe temperaturë trupi mbi 38°C, konsultohuni me pediatrin e zgjedhur.

I urojmë fëmijës suaj shërim të shpejtë!

Ekipi i mjekëve kirurgë për fëmijë dhe adoleshentë

Reparti i Pediatriisë
Kodi i katalogut: POo-03
Tetor 2023, versioni 1

